



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZLAnr.102/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli - kryesues, Ramush Bardiqi dhe Hidajete Gashi Alaj – anëtar, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.10.2025, merr këtë:

VE N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZLAnr.102/2025, e datës 03.10.2025, parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 03.10.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendohet se më datë 01.10.2025, rreth orës 16:00, në qytetin e Skenderajt, është evidentuar vendosja e një posteri zgjedhor të kandidatit për asamble komunale nga radhët e PDK-së, z. Dardan Shala, në hapësirë rekreative brenda parkut "Idriz Recë", përkatësisht në rrugën "Fadil Rustemaj". Ky veprim është në kundërshtim me nenin 34 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili përcakton se materialet zgjedhore mund të vendosen vetëm në hapësira të përcaktuara për këtë qëllim nga komuna dhe me leje paraprake, ndërsa ndalohet vendosja e tyre në hapësira publike të tjera. Po ashtu, sipas nenit 7 paragrafi 2.10 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, ndalohet shprehimisht vendosja e materialeve të fushatës brenda zonave rekreative dhe parqeve publike. Provë: Fotografia e bashkëngjitur, e cila tregon qartë posterin e kandidatit Dardan Shala të vendosur brenda hapësirës rekreative të parkut "Idriz Recë". Vendosja e tillë e materialit zgjedhor, përveç se përbën shkelje të dispozitave të sipërpërmendura ligjore, cenon barazinë e subjekteve politike në procesin zgjedhor dhe përbën përdorim të paligjshëm të hapësirave të përbashkëta publike. Për këto arsye, kërkojmë nga PZAP që të konstatojë

shkeljen e bërë nga kandidati i PDK-së, z. Dardan Shala, dhe të ndërmarrë masat e parapara ligjore, duke përfshirë urdhrin për largimin e menjëhershëm të materialit të vendosur në kundërshtim me ligjin dhe shqiptimin e sanksioneve administrative të përcaktuara. Si provë në ankesë ka bashkangjitur disa fotografi.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës thekson se posteri i kandidatit Dardan Shala është vendosur në një hapësirë të lejuar me ligj, për arsye se kompania "Kabashi" posedon pëlqimin zyrtar të Komunës për vendosjen e postereve në atë zonë, kandidati Dardan Shala ka lidhur kontratë të rregullt me kompaninë "Kabashi" për shfrytëzimin e kësaj hapësire, dhe se të gjitha dokumentet përkatëse që e dëshmojnë këtë gjendje faktike janë të bashkëngjitura me këtë përgjigje në ankesë. Prandaj, PZAP-së i propozojnë që të refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr. 102/2025 të parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, të konstatohet se ankuesi nuk ka arritur që të argumentoj përgjegjësinë e PDK, të mbështetur në dëshmi të qarta dhe bindëse.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, të subjektit politik LVV dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik PDK, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik LVV, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Paneli ka gjetur se në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë nga subjekti politik PDK-së, ka vërtetuar faktin se me datë 12.09.2025 kanë lidhur kontratën me Nr. Protokolli 11/2025 në mes të kandidatit të subjektit politik PDK Dardan Shala dhe Kompanisë N.SH “Foto Kabashi” ku objekt i kësaj kontrate është dhënia për shfrytëzimin e hapësirave reklamuese të cilat gjenden në rrugën “Parku Indriz Rreci” në Skenderaj për periudhën prej 12.09.2025 e deri me 12.10.2025, kjo kompani ka marrë Pëlqimin e lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Skenderajt, 09-334/01-0002929/25, e datës 21.01.2025, lëshuar për N.SH “Foto Kabashi”. Pra vendosja e tyre posterave është në pajtim me nenin 5 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, Të drejtat dhe obligimet e subjekteve politike gjatë mbajtjes së tubimeve publike konkretisht nën paragrafi 1.2 *“të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes shtandeve apo në hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore”*.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla

janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtuesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa

ZL.Anr.102/2025 më datë 06.10.2025

Kryesues i Panelit

Kujtim Pasuli



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.